


SI TË ZBATOHEN LUTJET E KONTAKTIT (SALAT)



Fjala “Salat”

Lutja e Kontaktit në gjuhën Arabe të Kuranit quhet “Salat” që do të thotë “Kontakt”, kurse tradicionalisht në popullatën e keqinformuar shqiptare, ajo njihet me fjalën Indo-Iraniane “Namaz” që do të thotë “Përkulje.”

Ibrahimi: Burimi fillestar i Lutjeve të Kontaktit (Salatit)

Kurani na mëson në shumë sure që Nënshtrimi (në Arabisht “Islami”) është feja e Ibrahimit (2:135, 3:95, 4:125, 6:161 dh 22:78). Muhamedi ishte ndjekës i Ibrahimit siç mësojmë nga ajeti 16:123. Të gjithat zakonet fetare në Nënshtrim (Islam) na u dhanë neve nëpërmjet Ibrahimit; ato përfshijnë:

1. Pesë lutjet e përditshme të kontaktit (Salati),
2. Bamirësia e obligueshme (Zeqati),
3. Agjërimi gjatë Ramazanit, dhe
4. Haxhi në Mekë.

Në veçanti mësojmë nga Kurani (21:73) që Lutjet e Kontaktit (Salati) dhe bamirësia e obligueshme (Zeqati) iu dhanë Ibrahimit (Abrahamit).

Një numër i madh i ajeteve të Kuranit na mësojnë që Lutjet e Kontaktit ishin në ekzistencë, të paprekura, dhe të praktikuar para ardhjes së Muhamedit (shih për shembull 8:35 & 9:54).

Të gjitha pozitat e Lutjeve të Kontaktit gjenden në Kuran, duke përfshirë, pozitën në këmbë (3:39, 39:9), pozitën e përkuljes, dhe përluljes (Ruku dhe Sexhud)(2:43, 3:43, 9:112, 22:26, 22:77).

Pesë Kohët e Salatit përmenden në veçanti në Kuran

1. **Lutja e Agimit** përmendet me emër në 24:58. Para lindjes së diellit.
2. **Lutja e Mesditës (Drekës)** përmendet në ajetin 17:78. Kur dielli bie teposhtë.
3. **Lutja e Pasdites** gjendet në ajetin 2:238. Në mes të mesditës (drekës) dhe perëndimit të diellit.
4. **Lutja e Mbrëmjes** përmendet në 11:114. Menjëherë pas perëndimit të diellit.
5. **Lutja e Natës** përmendet në 11:114, dhe përmendet me emër në 24:58.

Thirrja për Lutje (Ezani)

Ezani nuk është pjesë e Lutjeve të Kontaktit, dhe as nuk është i domosdoshëm. Por është bërë traditë në shoqëritë Myslimane që t'i mbledhin njerëzit për lutje nëpërmjet një thirrjeje me zë të lartë. Ezani original fillestar ishte në përputhje me mësimet e Kuranit, por u ndryshua me kalimin e kohës.

Në fillim, thirrja për lutje përbëhej nga:

1. Allahu Ekber (Zoti është i madh), 4 herë.
2. La ilahe ila Allah (Nuk ka zot përveç Zotit), një herë.

Shumë vite më vonë, disa njerëz e shtuan emrin e Muhamedit te Ezani. Kjo bie në kundërshtim me urdhrat e Zotit në ajetet 2:136, 2:285, 3:84, 4:150 dhe 72:18. Më vonë, disa grupe të tjera të Myslimanëve shtuan emrat e Alisë dhe familjes së tij. Sot Ezani është tejet i korruptuar dhe i ndryshuar nëpër botën Myslimane, dhe përbën idhujtari, e jo Nënshtrim ndaj VETËM Zotit.

Ezani i Saktë

Nëse e zbaton lutjen e kontaktit vetë, atëherë Ezani nuk ju nevojitet. Ezani zakonisht zbatohet kur një grup njerëzish janë gati për të zbatuar lutjen. Njëri person ngrihet në këmbë dhe i thotë fjalët e Ezanit, ose i këndon ato si në vijim:

Allahu Ekber, Allahu Ekber (Zoti është i madh, Zoti është i madh).

Allahu Ekber, Allahu Ekber.

La ilahe ila Allah (Nuk ka zot tjetër përveç Zotit).

Përgatitja për Lutjen e Kontaktit (Avdesi)

O ju që besoni, gjatë përgatitjes për lutje të kontaktit, duhet të:

1. Lani fytyrat tuaja,
2. Lani duart deri në bërryla
3. Fërkoni kokat me duar të lagëta,
4. Dhe lani këmbët deri në zogj të këmbëve.

[Kuran 5:6]

Sikur të gjitha aspektet e Nënshtrimit, Myslimanët e kanë korruptuar avdesin duke shtuar hapa të pa-autorizuar në të. Për ironi, shpikjet e tilla u veshën dhe përkrahën me aq autoritet të madh sa që kushdo që i vë në dyshim ato, e akuzojnë për shpikje!!

Për këtë arsye është me rëndësi kyçe që t'i përmbahemi urdhrave të Zotit duke e zbatuar saktësisht avdesin ashtu siç është shpallur në Kuran. Çfarëdo veprimesh tjera të shtuara në avdes përfaqësojnë një zot tjetër përkrah Zotit.

Avdesi i tërësishëm (Iarja)

Pas cilitdo aktiviteti seksual që shkakton orgazëm, ne duhet të lahemi tërësisht ose të bëjmë dush para se ta bëjmë lutjen e kontaktit (4:43).

Avdesi i thatë (Tejemum)

Nëse nuk mund të gjejmë ujë, ne duhet të prekim dhe të pastër të thatë, dhe pastaj t'i fërkojmë duart tona dhe fytyrat tona. Kjo mjafton si zëvendësim për avdesin në atë rast (4:43, 5:6).

Çka e prishë avdesin

Jashtëqitjet nga ushqimi i tretur nëpërmjet zorrëve, duke përfshirë gazrat, materiet e thata, dhe urina e prishin avdesin. Gjumi gjithashtu e prishë avdesin, pasi që atëherë bëhemi të pavetëdijshëm. Pra ne mund t'i zbatojmë lutjet e kontaktit me një avdes me kusht që të mos shkojmë në nevojtoje, nxjerrim gaz, ose të biem në gjumë.

SI T'I ZBATOJMË LUTJET E KONTAKTIT

1. Kthehuni nga Meka (Kiblah):

Kjo është pikë organizative e shpallur nga Zoti në ajetin 2:125. Zoti do që të gjithë të nënshtruarit të kthehen nga drejtimi i njëjtë kur ata zbatojnë lutjet e kontaktit. Në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe shtetet tjera të Ballkanit ky drejtim është në Juglindje.

2. Qëllimi (njeti)

Në gjuhën tënde, (në shqip), pa zë ose me zë, thuaje njetin (qëllimin) tënd që e keni njet të zbatoni Lutjen e Kontaktit. Mos harroni të përmendni kohën e lutjes (të Agimit, të Mesditës, të Pasdites, të Mbrëmjes, ose të Natës).

3. Ngrini duart anash fytyrës suaj:

Gishtat e mëdhenj të duarve t'i prekin veshët tuaj, dhe shuplakat e duarve janë të kthyera para.



4. Thuaj "Allahu Ekber".

Përderisa i ngrini duart anash fytyrës suaj, atëherë lëvizni ato poshtë anash në mënyrë të pandërprerë, dhe thuani, **"Allahu Ekber"** (Zoti është i Madh). Kjo e fillon lutjen e kontaktit. Tani jeni në kontakt me Krijuesin tuaj.



5. Qëndrimi në këmbë:

Tani jeni duke qëndruar në këmbë me duart teposhtë në mënyrë të thjeshtë anash, ose disa njerëz e vendosin dorën e majtë në bark, dhe dorën e djathtë mbi dorën e majtë. Secila pozitë është në rregull – pra mund t'i vendosni duart në bark përderisa qëndroni në këmbë, ose mund t'i lëni duart teposhtë anash pa i vendosur në bark.



6. Recitoje "Çelësin" (Suren 1) Arabisht:

Mësojmë nga ajeti 2:37 që Zoti na jep neve fjalët me të cilat ne vendosim kontakt me Të. Ne duhet t'i themi zërat (fjalët) e caktuar që janë diktuar në Suren e parë të titulluar "Çelësi". Përkthimi i Çelësit është nga dora e njeriut. Tingujt Arabisht të "Çelësit" përbëjnë një kombinim numerik që e hapë thesarin. Sikur një numër i telefonit, nëse nuk shtypen numrat e saktë, nuk mund të biem në kontakt me atë që dëshirojmë. Kjo është e tërë Arabishtja që të duhet. Të gjitha të tjerat mund të thuhën në gjuhën tënde. Recitimi i "Çelësit", sures së parë, Arabisht i bashkon të gjithë të Nënshtruarit e botës, pa marrë parasysh gjuhën e tyre.

aÇelësi:

1. **BISMILAHİ ERRAHMAN ERRAHİM.**
(Në emër të Zotit, Më të Hirshmit, Më të Mëshirshmit)
2. **ELHAMDU LILAHİ RABIL ALEMIN.**
(Lavdi Zotit, Zotit të gjithësisë)
3. **ERRAHMAN ERRAHİM.**
(Më i Hirshmi, Më i Mëshirshmi)
4. **MALIKI JAUM EDİN.**
(Sundues i ditës së gjykimit)
5. **IJAKA NA'ABUDU, UE IJAKA NESTAIN.**
(Vetëm Ty të adhurojmë, dhe vetëm Ty të kërkojmë ndihmë)
6. **IHDINA SIRATA ALMUSTEKİM.**
(Udhëzoni në rrugën e drejtë)
7. **SIRATA LEDHINE EN'AMTE ALEJHİM; GHAJRIL
MAGHDUBI ALEJHİM UELED-DALİN.**
(në rrugën e atyre që i bekove; e jo të atyre që merituan zemërim, e as të humburve)


Pasi që “Çelësi recitohet 17 herë në ditë, do të jetë e lehtë për ju që ta recitoni dhe kuptoni brenda disa javëve; do të bëhet sikur gjuha juaj amtare.

7. Pozita e përkulur (Ruku)

Pas recitimit të “Çelësit” gjatë qëndrimit në këmbë, përkuluni në pozitën Ruku. Siç shihet në figurën e paraqitur, përkuluni në bel, dhe mbajini gjunjët drejtë, dhe vendosini duart në gjunjë. Shikimin e syve e drejtoni drejt rreth gjysmë metri para jush.

Përderisa lëvizni prej pozitës në këmbë drejt pozitës së përkulur thuani, “**Allahu Ekber**”.


Përderisa jeni të përkulur thuani “**Subhana Rabiël Adhim**” ose “I madhëruar qoftë Zoti, i Madhi”



8. Qëndrimi në këmbë:

Përderisa lëvizni nga pozita e përkulur drejt pozitës në këmbë thuani, “**Semi Allahu Limen Hamidah**” ose “Zoti iu përgjigjet atyre që e madhërojnë Atë”.


Qëndroni në pozitën në këmbë vetëm një sekondë, dhe pastaj bini në përlulje (sexhde). Përderisa lëvizni nga pozita në këmbë drejtë pozitës së përlulur thuani, “**Allahu Ekber**”.



9. Pozita e përlulur (Suxhud):

Nga pozita në këmbë bini në gjunjë, dhe vendoseni ballin në tokë rreth gjysmë metri para gjunjëve tuaj.

Gjatë përluljes thuani, “**Subhana Rabiël Ala**” ose “I madhëruar qoftë Zoti, Më i Larti”



10. Pozita e ulur.

Përderisa uleni nga pozita e përlulur, thuani, “**Allahu Ekber.**” Qëndroni në pozitën e ulur vetëm për një sekondë, dhe pastaj lëvizni drejt përluljes së dytë.

Përderisa lëvizni drejt përluljes së dytë thuani, “**Allahu Ekber.**”

Gjatë përluljes së dytë thuani, “**Subhana Rabiël Ala**” ose “I madhëruar qoftë Zoti, Më i Larti”. Pasi që të përfundoni përluljen (sexhden) e dytë, e keni përfunduar një njësi të plotë (një Reqat).



11. Ngrihuni në këmbë për njësinë (reqatin) e dytë.

Duke u ngritur në këmbë thuani, “**Allahu Ekber.**”

Lutja e Agimit

Kjo lutje e kontaktit përbëhet nga dy njësi (reqate).

Thjeshtë përsëritni hapat nga 5 deri në 11 edhe një herë.

Pra, kur lëvizni nga pozita e përlur herën e dytë thuani, “Allahu Ekber,” dhe qëndroni në pozitën e ulur. Përderisa qëndroni në pozitën e ulur e shprehni Shtyllën e Parë të Nënshtrimit, shahadetin:

**Esh-Hedu En La Ilahе Ila Allah,
Uahdahu La Sharike Lah.**



(Dëshmoj që nuk ka zot tjetër përveç Zotit. VETËM Ai është Zot; Ai nuk ka partner).

Ktheje kokën në anën e djathtë dhe thuaj, “Es-selamu Alejkum,” pastaj në anën e majtë dhe thuaje të njëjtën. Kjo e përfundon Lutjen e Agimit.

Lutja e Mesditës (Drekës)

Kjo lutje përbëhet nga 4 njësi (reqate). Pra, i bëni dy njësitë e para saktësisht ashtu si shpjegohet për Lutjen e Agimit deri në pozitën e ulur. E shprehni Shtyllën e Parë (të njohur si “Shahadeti”) pastaj ngriheni në këmbë për njësinë e tretë. Nuk i thoni Selamet (Es-selamu Alejkum).

Përderisa ngriheni për njësinë e tretë thuani, “**Allahu Ekber.**” Njësia e tretë dhe e katërt janë të njëjta me dy njësitë e para.

Kur ngriheni nga përlulja e dytë e njësisë së katërt, thuani “**Allahu Ekber**” dhe qëndroni në pozitën e ulur. Në pozitën e ulur, e shprehni Shahadetin, dhe i thoni Selamet në të dyja anët (në të djathtë dhe në të majtë). Kjo e përfundon Lutjen e Mesditës.

Lutja e Pasdites

Kjo lutje është e njëjtë me Lutjen e Mesditës. Vetëm “Qëllimi” natyrisht që është i ndryshëm.

Lutja e Mbrëmjes

Kjo lutje përbëhet nga tre njësi. Hapat e secilës njësi janë ashtu siç janë dhënë hollësisht më lartë. Pra, kur e përfundoni përluljen e dytë të njësisë së dytë, qëndroni në pozitën e ulur, e recitoni Shahadetin, pastaj vazhdoni në njësinë e tretë dhe të fundit. Pas përluljes së dytë të njësisë së tretë, ndaleni në pozitën e ulur, e recitoni “Shahadetin” përsëri, pastaj i thoni Selamet në të dyja anët (në të djathtë dhe në të majtë). Kjo e përfundon Lutjen e Mbrëmjes.

Lutja e Natës

Kjo lutje është e njëjtë me lutjet e tjera që kanë 4 njësi, pra me lutjen e Mesditës dhe me Lutjen e Pasdites.

Lartësia e zërit gjatë Lutjeve të Kontaktit

[Kuran 17:110] ...Mos i thoni lutjet tuaja të Kontaktit (Salat) as me zë shumë të lartë, as pa zë; përdorni një zë mesatar...

Gjatë lutjes në grup, vetëm Imami (udhëheqësi i lutjes) dëgjohej; të gjithë të tjerët dëgjojnë.

Dy ose më shumë njerëz mund të zbatojnë Lutjet e Kontaktit së bashku. Njëri person e udhëheqë lutjen grupore, duke e recituar “Çelësin” në një zë mjaft të lartë për tu dëgjuar nga të gjithë në grup. Zërat tjerë duhet të mos dëgjohej. Kushdo mund t'i bashkëngjitet grupit më vonë, në mes të lutjes. Ai ose ajo duhet të bëjë të njëjtat lëvizje si grupi. Pastaj, në fund të lutjes, ai ose ajo duhet të ngrihet në këmbë dhe të kompensojnë pjesën e mbetur të lutjes që iu ka ikur.

Lutja e të Premtes

Lutja e Asamblesë e të Premtes (Salat El-Xhumah) është aq e rëndësishme sa që një sure e tërë është titulluar “E Premtja” dhe urdhri shpallet në ajetin 62:9 që ta zbatojmë këtë lutje. Secili i Nënshtruar – burrë, grua, dhe fëmijë – urdhërohet nga Perëndia që të zbatojë Lutjen e Asamblesë së të Premtes.

Lutja e të Premtes zbatohet në vend të Lutjes së Mesditës çdo të Premte. Në vend të katër njësive, Lutja e të Premtes përbëhet nga dëgjimi i dy predikimeve të dhëna nga Imami, dhe nga dy njësi të lutjes.

Secili predikim i lutjes së të Premtes duhet të fillojë me **“El-Hamdu Lilah”** (Lavdi Zotit), **“La ilahe ila Allah”** (Asnjë zot përveç Zotit). Secili predikim duhet të zgjasë rreth 10 deri në 15 minuta dhe duhet të jepet në gjuhën e asamblesë, njerëzve të mbledhur (xhematit). Në fund të predikimit të parë, kërkohet nga xhemati që të pendohen, **“Tubu ila Allah.”** Imami pastaj ulet për rreth një minutë dhe pendohet së bashku me asamblenë (xhematin), pastaj ngrihet në këmbë për predikimin e dytë. Predikimi i dytë përfundon duke kërkuar nga njëri nga njerëzit që të këndojë Ezanin. Imami e udhëheqë lutjen me dy njësi.

Në fund të secilës lutje

Adhuresit mund t'i japin dorën njëri tjetrit, të përqafohen, dhe/ose të shkëmbejnë përshëndetje pas përfundimit të lutjes. Zakonisht i thuhet njëri tjetrit “Urime.” Kjo është për shkak se Lutjet e Kontaktit janë dhuratë nga Zoti që na ndihmon që të zhvillojmë dhe ushqejmë shpirtat tonë. Ia vlen të urohet dikush që ka arritur një bekim aq të madh.

Pasi që lutjet e kontakti zbatohen në praktikë, është e rëndësishme të shihet se si bëhen ato nga dikush tjetër. Detaje të mëtutjeshme jepen me anë të videove, dhe mund të gjenden në faqen e internetit:

masjidtucson.org/albanian

E-mail adresa:

xhamiashqiptare@gmail.com